VENDIM
Nr.34, datë 12.6.2006

PËR MIRATIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, PËR VITIN 2005 PËR SHOQËRINË "EMIKEL" SHPK

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa b, 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", me ndryshimet e ligjit nr.9512, datë 10.04.2006 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe vendimit nr.60 datë 29.12.2004 të Bordit të Komisionerëve "Për miratimin e të dhënave bazë në lidhje me aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël", Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 12.06.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga "Emikel" sh.p.k., për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për vitin 2005,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga "Emikel" sh.p.k., për periudhën nga 01.01.2005 deri më 31.12.2005, të jetë 4.52 lekë/kWh.
2. Ngarkohet "Emikel" sh.p.k. dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema